

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10961

Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për servisimin e sistemit të ngrohjes qendrore në objektin e Administratës komunale, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, rreth lejimit të servisimit të sistemit të ngrohjes qendrore në objektin e Administratës komunale të Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për blerjen e dy autoveturave-pikap për nevojat e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth lejitimit të blerjes së dy autoveturave-pikap, për nevojat e Komunës së Prizrenit, përkatësisht për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, të datës 28.9.2012, për pranimin e disa personave me aftësi të kufizuar që të punojnë përkohësisht në ndonjë prej drejtorive komunale, si dhe lejinin e mjeteve për pagesën e mëditjeve për këta persona, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës - Zyrës për Çështje Gjinore, i datës 28.9.2012, për pranimin e disa personave me aftësi të kufizuar që të punojnë përkohësisht në ndonjë prej drejtorive komunale, kështu që lejohet pranimi i 5 personave me aftësi të kufizuar që të punojnë dy javë (10 ditë pune) në ndonjë prej drejtorive komunale dhe atë me gjysmë orari të punës zyrtare, duke filluar nga data 15.10.2012.

Neni 2

Në emër të punëve të kryera 5 personat me aftësi të kufizuara, të cilët do të përzgjidhen që të punojnë, do të kompensohen nga Komuna dhe atë me nga 100 € për person.

Neni 3

Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave që të gjejë formën dhe modalitetet e pagesës së mjeteve financiare për këta persona.

Neni 4

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 2 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës së Prizrenit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 6

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, të datës 1.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Gruaja Bashkëkohore”, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës-Zyra për Çështje Gjinore, i datës 1.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për OJQ “Gruaja Bashkëkohore”, me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve të tyre, përkatësisht për përkrahje të projektit: “Për një jetë më të mirë në shoqëri”, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas kërkesë të Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së për lejimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të invalidit të luftës, Elez Kastrati, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet kërkesa e Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së nr. 01/400-8103, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të invalidit të luftës Elez Kastrati, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 500 €.

Mjetet lejohen në emër të familjes së Elez Kastratit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10961

Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të datës 1.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për furnizim me kripë industriale për mirëmbajtje dimërore të rrugëve, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 1. 10. 2012, rreth lejitimit të furnizimit me 500 tonelata kripë industriale për mirëmbajtje dimërore të rrugëve, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 1.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin e tribunës shkencore të quajtur “Biodiversiteti i Komunës së Prizrenit”, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 1.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për përkrahje financiare për organizimin e tribunës shkencore të quajtur “Biodiversiteti i Komunës së Prizrenit”, e cila tribunë do të realizohet nga Qendra për Edukim, Trajnim dhe Huluntim Shkencore “Ozoni”, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2900 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shërbime Publike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Shërbimeve Publike, Drejtorja e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të datës 2.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale në fshatin Zhur, me elemente të betonit sipas praktikës së participimit, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 2.10.2012, rreth lejitimit të ndërtimit të disa rrugëve lokale në fshatin Zhur, me elemente të betonit sipas praktikës së participimit. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ndërtimin e:

1. Rrugës “Susuri”,
2. Rrugës “Badallaj-I dhe II”,
3. Rrugës në fshatin Landovicë,
4. Rrugës “Elezkurtaj”,
5. Rruga e “Varrezave-te lagjja Badallaj”;

Për realizimin e këtyre projekteve, Komuna e Prizrenit do të participojë me 70 % të vlerës së projektit, ndërsa komuniteti me 30 %.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, komuniteti, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 2.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Nënkyetarit të Komunës së Prizrenit për formimin e Komisionit për vlerësimin e aseteve të EULEX-it në Prizren, kryetari i Komunës, më 2 tetor 2012, miratoi këtë:

A K T V E N D I M

I. Formohet dhe emërohet Komisioni për vlerësimin e aseteve të EULEX-it në Prizren. Për anëtarë të këtij komisioni, emërohen: 1. Ahmet Krasniqi, kryetar i Komisionit, 2. Ylber Gashi dhe 3. Ramadan Tafallari.

II. Detyrat e komisionit do të jenë: Të bëjë vlerësimin e aseteve të EULEX-it në Prizren, të cilat i u janë dhënë Komunës së Prizrenit, t'ju caktojë çmimin fillestar për shitje nëpërmjet ankandit të këtyre aseteve, të verifikojë regjistrin e aseteve, të hartojë procesverbalin përkatës.

III. Komisioni, nga pika I e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Komisionit për Ankesa, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen nënkryetari i Komunës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim të njoftohen nënkryetari i Komunës, të emëruarit dhe Arkivi.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-10961

Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të komunës për shpërndarjen e shpenzimeve të telefonisë mobile nga fatura 120701043753/233, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Lejohet shpërndarja e shpenzimeve të telefonisë mobile të faturuara në faturën nr. 120701043753/233 në shumën prej 607,7107 € për:

- a. Drejtorinë e Administratës.....325,7107 €,
- b. Drejtorinë e Arsimit dhe Shkencës.....195,00 € dhe
- c. Drejtorinë e Shëndetësisë.....87,00 €.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 3

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës, të datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuara lidhur me pritjen e delegacionit të qytetit të Kyjovit të Republikës së Çekisë, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës, i datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuara lidhur me pritjen e delegacionit zyrtar të qytetit të Kyjovit të Republikës së Çekisë në komunën e Prizrenit, nga data 1 tetor deri me 4 tetor 2012, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 2.606 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të nënkryetarit të Komunës, të datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të koktejit, i cili do të shtrohet për personat me aftësi të kufizuara, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës, i datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të koktejit, i cili do të shtrohet për personat me aftësi të kufizuara në kuadër të muajit për persona me aftësi të kufizuara, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet financiare në shumën prej 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: nënkryetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: nënkryetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik të datës 1.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për botimin e katalogut kulturor “Prizreni, vendtakim i civilizimeve”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i datës 1.10.2012, rreth lejimit për botimin e katalogut kulturor “Prizreni, vendtakim i civilizimeve”. Kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit përkatës për botimin e këtij katalogu dhe atë 1000 copë në gjuhën shqipe dhe 1000 copë në gjuhën angleze.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik të datës 1.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e ambientit të jashtëm-oborrit të “Beledijes”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik i datës 1.10.2012, rreth lejimit të rregullimit të ambientit të jashtëm-oborrit të “Beledijes” (ana e majtë e objektit), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik të datës 1.10.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e hapësirës tek stacioni i autobusëve në lagjen ‘Ralin’, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 1.10.2012, rreth lejimit të rregullimit të hapësirës tek stacioni i autobusëve në lagjen ‘Ralin’ në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 4.10.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për izolimin e konstruksionit meskatësh në SHMM “Lorenc Antoni”, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës , i datës 4.10.2012, për lejitimin e izolimin të konstruksionit meskatësh, përkatësisht plafonit në Shkollën e Mesme të Muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, të datës 4.10.2012, rreth lejimit të punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë për projektin “Punimi i rrethojës së oborrit të ShFMU “Lekë Dukagjini”, kryetari i Komunës, më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

MIRATOHET propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 4.10.2012, rreth lejimit të punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë për projektin “Punimi i rrethojës së oborrit të ShFMU “Lekë Dukagjini”, kështu që për realizimin e tërësishëm të këtij projekti lejohen punimet shtesë dhe mjete shtesë nga buxheti i Komunës.

Në emër të këtyre punimeve shtesë, lejohen mjetet shtesë në shumën prej 3570 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i investimeve kapitale të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, punëkryerësi, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, të datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të dy pacientëve, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 2.10.2012, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve; 1. Drita Haziraj dhe 2. Dalip Morina. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtorja e Shëndetësisë, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Asociacionit “Arena” rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e shkollës verore zbavitëse të futbollit për fëmijë “Open fun football school”, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bazuar në kërkesën e Asociacionit “Arena” nga Prizreni, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për organizimin e shkollës verore zbavitëse të futbollit për fëmijë “Open fun football school”, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1800 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, të datës 8.10.2012, rreth ndryshimit dhe plotësimit të konkluzionit nr. 01/06-8255 të datës 31.7.2012, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 8.10.2012, rreth ndryshimit dhe plotësimit të konkluzionit nr. 01/06-8255 të datës 31.7.2012, që ka të bëjë me lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit “Masterplani i Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Prizrenit”, kështu që fjala “Masterplan” ndryshohet dhe do të jetë “Strategjia”

Pjesët e tjera të konkluzionit nr. 01/06-8255 të datës 31.7.2012, mbesin të pandryshuara.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, rreth lejimit të udhëtimit zyrtar për në Durrës të Republikës së Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Visar Islamajn, kryetari i Komunës, më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, për lejimin e udhëtimit zyrtar të zyrtarit ligjor Visar Islamaj, me qëllim të pjesëmarrjes në punëtorinë që ka të bëjë me harmonizimin e rregulloreve komunale dhe vendimeve me ligjet dhe aktet nënligjore, që do të mbahet nga data 8 tetor deri me 12 tetor 2012 në Durrës të Republikës së Shqipërisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Serbi dhe pagesës së shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesës së mëditjeve për Igbalka Ramën, kryetari i Komunës, më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejitimin e udhëtimit zyrtar të Igbalka Ramës për pjesëmarrjen në vizitën e quajtur “Shko dhe Informohu”, me qëllim të takimit me personat e zhvendosur të komuniteti serb nga Komuna e Prizrenit, që aktualisht qëndrojnë në Serbi. Vizita do të realizohet nga data 11 tetor deri me 12 tetor 2012, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe mbulimi i shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurën.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-10961
Më 9.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për rregullimin e ndriçimit dhe kyçjes në rrjetin elektrik për shkollën fillore në fshatin Mushnikovë, kryetari i Komunës më 9 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, rreth lejimit të mjeteve për mbështetje financiare për realizimin me bashkëfinancim të projektit “Rregullimi i ndriçimit dhe kyçja në rrjetin elektrik të shkollës fillore në fshatin Mushnikovë”, kështu që, Komuna e Prizrenit bashkëfinancon në këtë projekt dhe për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 4970.

Në këtë projekt IOM-i bashkëfinancon me 6000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicionet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Prizrenit

Kryetari i Komunës

Nr. 01/06-zyrtar

Më 8.10.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Shqipëri dhe pagesës së mëditjeve për Samir Hoxhën, drejtori i DZhET, kryetari i Komunës, më 8 tetor 2012, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, për lejinin e udhëtimit zyrtar të Samir Hoxhës, drejtori i DZhET, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin që ka të bëjë me zhvillimin rural përmes promovimit të turizmit në regjionin Sharrit, që do të mbahet nga data 13-14 tetor 2012 në Theth të Republikës së Shqipërisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

